

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga shkolla pas dy ditësh, alarm për sigurinë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/harry-dhe-meghan-terheqin-femijet-nga-shkolla-pas-dy-ditesh-alarm-per-sigurine/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:42:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	57543ca3ee14c1bd8a1bc317ff6d4c000b55b2639c788e2eae04fe523a1434a8
TEKSTI	c6b6d3112ea77843349dc2e50971bfdd36c7f121c4ef700955a5810d5addb53a
PAMJA	f4eed0c56bcf850dfc2288a75f7c1faaecbc5e9aac5b6ae1039395090c1efb52

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1df3f7e6e20757767b6269b82d310ff24fe8c3ee7b8a424ac621e23270636ace
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1df3f7e6e20757767b6269b82d310ff24fe8c3ee7b8a424ac621e23270636ace>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga shkolla pas dy ditësh, alarm për sigurinë

BOTË

Demo

Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga shkolla pas dy ditësh, alarm për sigurinë

SEPTEMBER 14, 2026



Princi Harry dhe Meghan Markle kanë tërhequr fëmijët e tyre, Princin Archie dhe Princeshën Lilibet, nga shkolla e tyre e re në Britani, vetëm dy ditë pasi nisën mësimet. Sipas ITV News, vendimi lidhet me shqetësimet për sigurinë e familjes.

Burimet e cituara nga mediat britanike bëjnë me dije se çifti ka diskutuar me ekipin e tyre të sigurisë për rreziqet e mundshme ndaj fëmijëve dhe, pas këtyre bisedimeve, ka vendosur t'i largojë nga shkolla.

Archie, shtatë vjeç, dhe Lilibet, pesë vjeç, ishin regjistruar në një shkollë përgatitore britanike, pasi familja ishte zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar pas disa vitesh qëndrimi në SHBA. Sipas raportimeve, fëmijët tashmë "po fillojnë diku në një shkollë tjetër".

Vendimi vjen në një kohë kur siguria e Harry-t, Meghan-it dhe fëmijëve të tyre po rishikohet nga autoritetet britanike. Komiteti Ravec, i Ministrisë së Brendshme, që vlerëson nivelin e mbrojtjes për anëtarët e familjes mbretërore dhe persona të tjerë me profil të lartë, thuhet se ka njoftuar Harry-n se do të kryhet një vlerësim i plotë i rrezikut ndaj tij dhe familjes.



Korrespondenti mbretëror i ITV News, Chris Ship, raporton se ky shqyrtim lidhet edhe me faktin që Harry tashmë jeton në vendin e tij të lindjes dhe fëmijët e tij kanë nisur të ndjekin shkollën në Britani.

Postimet e reja

Harry dhe Meghan tërheqin fëmijët nga...

SEPTEMBER 14, 2026

Zelensky paralajmëron Evropën: Mos harroni...

SEPTEMBER 14, 2026

Rrahën barbarisht një indian në Thiva,...

SEPTEMBER 14, 2026

17 vite pas ekzekutimit të Franc Konomit, familja...

SEPTEMBER 14, 2026

Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar lute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

Bëhet fjalë për një rishikim të rëndësishëm për Sussex-ët, pasi rreziku ndaj Meghan Markle nuk ishte vlerësuar në të njëjtën mënyrë që nga largimi i çiftit nga detyrat si anëtarë të familjes mbretërore në vitin 2020.

Harry prej vitesh është përfshirë në një përplasje ligjore me Ministrinë e Brendshme për nivelin e mbrojtjes që i ofrohet gjatë qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Pas tërheqjes nga detyrat mbretërore dhe zhvendosjes në Kaliforni, atij iu hoq e drejta për mbrojtje policore të financuar nga taksapaguesit.

Duka i Sussex-it ka argumentuar se statusi i tij si djali i mbretit britanik, i pesti në radhën e fronit dhe veteran i ushtrisë e bën të domosdoshme mbrojtjen policore kur ndodhet në Britani.

Pas një disfatë të mëparshme ligjore, Harry i kishte thënë BBC-së se nuk mund ta imagjinonte një moment kur do të ishte në gjendje ta sillte familjen e tij në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të sigurt.

Tashmë, me rikthimin e tij së bashku me Meghan dhe fëmijët për të jetuar në Britani, çështja e sigurisë së familjes është rikthyer në qendër të vëmendjes.



Sipas ITV News, aktualisht Sussex-ëve u është dhënë vetëm numri i telefonit të një oficeri ndërlidhës të policisë britanike, të cilin mund ta kontaktojnë në rast nevojë. Harry beson se kjo nuk përbën mbrojtje të mjaftueshme në rast të një kërcënimi të menjëhershëm.

Ndërkohë, çifti shpenzon miliona për sigurinë private. Megjithatë, në Mbretërinë e Bashkuar trupat private të Harry-t dhe Meghan-it nuk lejohen të mbajnë armë, ndryshe nga rregullat që zbatohen në disa raste në SHBA.

Scotland Yard nuk komenton për masat specifike të sigurisë që lidhen me familjen mbretërore, ndërsa burime të cituara nga mediat britanike thonë se niveli i mbrojtjes përcaktohet rast pas rasti dhe rishikohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ministria e Brendshme britanike dhe ekipi i Sussex-ëve janë kontaktuar për një koment lidhur me zhvillimet, por deri tani nuk kanë dhënë një përgjigje.

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

Horoskopi i dashurisë për këtë
javë

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.